

VENDIM
Nr. 299, datë 20.4.2016

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 54, DATË 5.2.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURËS E TË
MËNYRËS SË DHËNIES ME QIRA, ENFITEOZË APO KONTRATA TË TJERA TË
PASURISË SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, të miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, dhe të neneve 784 e 801, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun VI, “Monitorimi i kontratave”, të vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 6 shtohen pikat 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“7. Në rastet kur në kontratat e qirasë, të lidhura përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, pala qiradhënëse shtetërore ka qenë e përfaqësuar në kontratë nga disa institucione, institucioni që do të përfaqësojë qiradhënësin dhe që do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe/apo ndryshimin e kontratës do të jetë institucioni shtetëror që ka përfituar qiranë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës apo, nëse ka pasur më tepër se një institucion shtetëror, i cili përfitonte qiranë, institucioni i cili e përfiton qiranë aktualisht.

8. Në rastet kur kontratat e qirasë janë të lidhura përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare”, pala qiramarrëse ka të drejtë t’ia transferojë kontratën e qirasë një personi juridik ku qiramarrësi është aksionar apo ortak.

Institucioni përgjegjës për monitorimin e kontratave të qirasë, sipas pikës 8 më sipër, njofton ministrinë përgjegjëse për ekonominë për transferimin e bërë, sipas këtij paragrafi, dhe për të gjitha çështjet e tjera që lidhen me monitorimin, sipas kreut VI të këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama